



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

## THIRRJE PUBLIKE

**PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTPROPOZIME TË  
ORGANIZATAVE JOQEVERITARE, DHE BIZNESEVE, NË FUSHËN:**

*Prodhimi i shfaqjeve teatrale, për TEATRIN PËR FËMIJË dhe për SKENËN E  
MBRËMJES, për repertorin e TQP Dodona.*

Udhëzimet për aplikues

Data e hapjes së thirrjes: më 22.04.2022

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: më 20.05.2022

## PROBLEMET TË CILAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE

Komuna e Prishtinës kujdeset për jetën kulturore të kryeqytetit dhe me këtë synim ofron përkrahje për OJQ dhe biznese, programi i të cilëve është i fokusuar në fushën e kulturës.

Në këtë vijë, Komuna e Prishtinës synon pasurimin e jetës kulturore të qytetit, rritjen e llojllojshmërisë së aktiviteteve, tërheqjen e numrit sa më të madh të publikut në aktivitete, tërheqjen e turistëve në këto aktivitete të krijuara, si dhe në promovimin e kulturës dhe aktiviteteve të të gjithë qytetarëve.

### OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

Objektivi/objektivat e përgjithshme të kësaj thirrje janë, që Komuna e Prishtinës të ofrojë përkrahje për TQP Dodona si dhe për biznese, OJQ, programi i të cilëve është i fokusuar në fushën e kulturës, dhe ofron mbështetjen e tyre me transparencë të plotë dhe pa kurrfarë diskriminimi.

Objektivat specifike të thirrjes janë:

- Mbështetja e repertorit të Teatrit të Qytetit të Prishtinës (TQP) "Dodona";
- Të fuqizohen krijuesit e pavarur dhe krijuesit e rinj që veprojnë në Komunën e Prishtinës;
- Të prodhohen punë të reja kulturore/artistike;
- Të ketë shtrirje të gjerë dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në jetën kulturore/artistike në Komunën e Prishtinës;
- Të sigurohet mbështetje për institucionet kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës dhe institucionet e pavarura kulturore që veprojnë në Komunën e Prishtinës;
- Të mbështetet puna në grupe dhe bashkëpunimi ndër-disiplinar dhe ndër sektorial;
- Të përkrahën punë me përmbajtje kritike, të cilat synojnë të sfidojnë pabarazi sociale dhe ekonomike;

- Të përkrahen punë me përmbajtje Feministe;
- Të stimulohet inovacioni teknologjik në të gjitha fushat kulturore/artistike;
- Të inkurajohen personat me nevoja të veçanta për pjesëmarrje dhe prodhim në sektorin e artistik dhe kulturor.

#### VLERA E PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE SHUMA E PËRGJITHSHME E THIRRJES

- Vlera e përgjithshme e planifikuar për këtë thirrje është 50,000.00€ (Euro). Shuma maksimale për një projekt është 16,000.00€ (euro).

#### MËNYRA E APLIKIMIT, PËRSHKRIMI I FUSHAVE, KUSHTET FORMALE DHE KRITERET QË DUHET PLOTESUAR APLIKANTËT

##### MËNYRA E APLIKIMIT

- Aplikimi bëhet përgjatë thirrjes së hapur, përmes mënyrës elektronike online <http://krs.prishtinaonline.com/>.

##### PËRSHKRIMI I FUSHËS

Përshkrim i fushës në të cilën aplikanti mund ta parashikojë zbatimin e programeve apo projekteve përgjatë aplikimit:

**Teatër:** prodhimi i shfaqjeve teatrore, për TEATRIN PËR FËMIJË dhe për SKENËN E MBRËMJES, për repertorin e TQP Dodona si mëposhtë:

- a) Komedi – SKENA E MBRËMJES;
- b) Dramatizim/adaptim – SKENA E MBRËMJES;
- c) Dramë – SKENA E MBRËMJES;
- d) Solo performancë/ monodramë/ stand-up comedy – SKENA E MBRËMJES;
- e) Shfaqje për fëmijë (mund të jetë shfaqje vetëm me kukulla, vetëm me aktorë në skenë, apo edhe e kombinuar) - TEATRI PËR FËMIJË.

## KRITERET QË DUHET TË I PLOTËSOJNË APLIKANTËT

### **Kriteret e përgjithshme**

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- të jenë të regjistruar si OJQ, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asocijimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës, apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;
- të jenë të pajisur me numër fiskal, sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-në e huaj;
- të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
- të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete, dhe
- të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

### LISTA E DOKUMENTEVE TË DETYRUSHME TË THIRRJES PUBLIKE

- Aplikacioni online;
- **Për OJQ-të:**
  - Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
  - Certifikata e nr. fiskal;
  - Vërtetimi/konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
  - Kopja e letërnjoftimit/ pasaportës së përfaqësuesit të OJQ-së;
  - Vërtetimin që OJQ nuk kanë obligime tatimore (nga ATK).
- **Për biznese:**
  - Certifikata e Biznesit (me Numër Unik Identifikues nga ARBK);

- Vërtetimi/konfirmimi i llogarisë bankare të biznesit (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- Kopja e letërnjoftimit/ pasaportës të përfaqësuesit të biznesit;
- Vërtetimin që Biznesi nuk ka obligime tatimore (nga ATK).

### **Lista e dokumenteve specifike të thirrjes publike:**

- Biografia e autorit/es;
- Deklarata e autorit/es (që ia jep të drejtën aplikantit për të konkurruar me dramën/veprën e autorit përkatës);
- Sinopsisi i dramës;
- Një pjesë e dramës (p.sh. 10 faqet e para);
- Biografia e regjisorit/es;
- Koncepti regjisorial;
- Biografi të anëtarëve tjerë të ekipit kreativ (nëse janë përzgjedhur);

## **KUSHTET FORMALE TË THIRRJES**

### **Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes**

Përmes fondeve publike të kësaj thirrjeje publike, mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit/programit, do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

### **Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:**

- Blerja e pajisjeve për zyra;
- Renovime të objekteve;
- Dhurata, mirënjohje dhe shpërblime të ngjashme.

- Shërbime administrative (pagesa e qerasë, derivate, ujit, rrymës, telefonit, internetit, mirëmbajtja e llogarisë bankare)

#### **Llojet e mëposhtme të aktiviteteve nuk janë të pranueshme për financim:**

- Aktivitete që nuk zhvillohen në komunën e Prishtinës;
- Aktivitete që përmbajnë diskriminim gjinor;
- Aktivitete që përmbajnë diskriminim fetar.

#### **PERIUDHA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT**

- Periudha e zbatimit të projektit është deri *në fund të muajit dhjetor, 2022.*

#### **DORËZIMI I APLIKACIONIT**

- Aplikacionin mund ta dorëzoni vetëm përmes mënyrës elektronike, online <http://krs.prishtinaonline.com/>,
- Aplikacionet në formë tjetër nuk prahen.
- Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike, mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [kultura.pr@rks.gov.net](mailto:kultura.pr@rks.gov.net), dhe në numrin e telefonit +383 38226417. Pyetjet mund të bëhet deri më 10.05.2022.
- Afati për dorëzimin e propozimeve është deri më **20.05.2022, ora 16:00h**, përmes aplikacionit online, në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Prishtinës <http://krs.prishtinaonline.com/>
- Për ndihmë shtesë lidhur me mënyrën e aplikimit ju lutem klikoni në vegzën <https://www.youtube.com/watch?v=yZezaoKdi4E>